



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.03.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, relatore znj. Yllka Rupa.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 12:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Markelian Koça*** (anëtar)

¹ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte të EWMI/INL.*
6. *Arben Lila, eksperti projektit EU4Justice.*
7. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, relatore *znj. Yllka Rupa*.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Ndjesë për vonesën për të filluar mbledhjen, por kishim probleme me pjesën e lidhjes së internetit këtu në sallë.

Atëherë edhe një herë për të gjithë ata që janë “online”, se Këshilli në fakt i diskutoi, por për pjesën “online”, sot kemi për të shqyrtuar nga ana e Këshillit rreth 7 çështje.

Nuk është e pranishme zonja Emona Muçi, për shkak të një angazhimi pranë Shkollës së Magjistraturës.

Kemi diskutime mbi përmbajtjen e rendit?

Po, Irena!

Irena Plaku: Unë në fakt do kërkoja një shtyrje për njëren nga pikat e rendit të ditës, konkretisht për vlerësimin e gjyqtarit Sokol Shehu, pasur parasysh kundërshtimet e tij, duke referuar disa çështje dhe duke qenë se kanë të bëjnë edhe me verifikimin e të gjitha akteve procedurale, kërkoj kohë që të jem më e qartë për sa i përket shpjegimeve lidhur me këtë çështje.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë çështjen në fjalë po e heqim nga rendi i ditës për t'i lënë kohë relatores që të plotësojë informacionin përpara se ta marrim në shqyrtim.

Pa humbur kohë po fillojmë me vlerësimet, kështu që fillojmë me çështjen e parë që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën 2013-2016. Relatore është znj. Yllka Rupa.

Atëherë, duke qenë se ne kishim mundësi ta dëgjonim, Yllka të lutem vetëm për efekt të regjistrimit të mbledhjes shkurtimisht vetëm konkluzionet.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Të nderuar kolegë!

Projektraporti i vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...} ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares e cila ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në projektraport pasqyrohet e plotë procedura e vlerësimit. Analizohen burimet e vlerësimit, niveli i pikëzimit. Kështu që në formë të përmbledhur do të relatoj thjesht lidhur me vlerësimin për gjithsecilin nga kriteret e vlerësimit.

Duke filluar me “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, 1.A. njohuritë ligjore, 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normave

konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete. Lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Për të kaluar tek 1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes. Referuar të dhënave, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Lidhur me këtë tregues i propozoj Këshillit nivelin e vlerësimit shumë të lartë, pikët 25.

Në lidhje me Arsytimin ligjor, në tërësi, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 15.

Lidhur me 1.B.b. Strukturën e qëndrueshme dhe e mirë organizuar të vendimit, në përgjithësi, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit gjyqësor. Kështu që propozohet edhe lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 10.

Për sa i takon 1.B.c. Cilësisë së analizës dhe argumentit logjik, në tërësi, në të gjitha vendimet burim vlerësimi rezulton një nivel arsytimi i plotë dhe i qartë, ku shqyrtohet dhe argumentohet çdo element të nevojshëm në raport me faktin penal që trajtohet. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Kështu që në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative të gjyqtares”, lidhur me 2.A.a. Respektimin e afateve ligjore. Në tërësi, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara, për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre. Propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë.

Gjithashtu edhe në lidhje me 2.A.b. Plotësimin e standardeve minimale kohore rezulton që në të gjitha çështjet për të cilat kërkohet plotësimi i standardit minimal kohor,

gjqqtarja të ketë respektuar standardin dhe për këtë arsye propozohet niveli maksimal i vlerësimit për këtë tregues, me 5 pikë.

Për sa i takon 2.A.c. Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, rezulton se për të gjitha kategoritë e çështjeve zbatohet standardi minimal kohor, pra ka qenë më e shkurtër standardi për të gjitha kategoritë. Gjyqtarja lidhur me këtë tregues duhet të pikëzohet në nivelin e 5 pikëve.

Në lidhje me rendimentin, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 116 %. Kështu që pikëzohet maksimalisht me 10 pikë.

Sa i përket 2.A.d. Kohës mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar, duke iu referuar burimeve të vlerësimit koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, kështu që propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë.

Në lidhje me “Aftësinë e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore”, për sa i takon 2.B.a Numrit mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja për shmangien e seancave joproductive justifikon pikëzimin e këtij treguesi me 15 pikë.

Në lidhje me 2.B.b Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i pikëzimit me 15.

Në lidhje me “Aftësinë e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore”, në të dyja aspektet edhe në aspektin e rregullshmërisë dhe dokumentacionit të dosjes po ashtu edhe saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes, paraqitet në nivele të larta gjyqtarja, kështu që propozohet niveli maksimal i pikëzimit 5 dhe 10 pikë.

Kështu që në lidhje me kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtares” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i takon “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, lidhur me “Etikën në punë”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues propozoj që gjyqtarja të vlerësohet në nivelin shumë të lartë, pikët 35.

Për sa i takon “Integritetit”, referuar të dhënave nga burimet arkivore KLD dhe KLGJ, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtares kështu që propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 40 lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon “Paanësisë së gjyqtares”, gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Kështu që në këto kushte, lidhur me këtë tregues propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 10.

Lidhur me “Numrin tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares”, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, kështu që ky tregues propozohet të vlerësohet në nivelin e 15 pikëve.

Kështu që në lidhje me kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional i gjyqtares”. Në lidhje me “Aftësitë e komunikimit”, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent. Nga ana tjetër respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale. Kështu që në lidhje me të dy këto tregues propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët përkatësisht 25 dhe 15.

Në lidhje me “Aftësinë për të bashkëpunuar”, në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët po ashtu edhe në aspektin e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, gjyqtarja paraqitet në nivel shumë të mirë, kështu që propozohet nivel shumë i lartë i vlerësimit, pikët 10 dhe 15.

Në lidhje me “Gatishmërinë e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, për sa i takon “Pjesëmarrjes së saj në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese (gjithsej janë 8 aktivitete) të zhvilluara për 21 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15-120 ditë në periudhën 3-vjeçare të vlerësimit. Kështu që lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit me 20 pikë.

Për sa i takon 4.C.b. Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnimin e gjyqtarëve”, do të fillojë vlerësimi lidhur me këtë tregues me 3 pikë si për të gjithë gjyqtarët e tjerë që janë në të njëjtat kushte pasi nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese apo të ketë udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional.

Për treguesin 4.C.c. Angazhimi i gjyqtares në veprimtari institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata, propozohet edhe në lidhje me këtë tregues pikëzimi me 3 pikë, pasi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton që gjyqtarja të mos jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Gjithashtu nuk rezulton që gjyqtarja të ketë publikime ligjore dhe akademike. Kështu që nuk vlerësohet për këtë tregues.

Lidhur me propozimin për nivelin e vlerësimit “Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional të gjyqtares”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Në lidhje me propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për gjyqtaren, propozohet si më poshtë:

Aftësitë profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative të gjyqtarit, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm, numri i pikëve 391, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".
Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

(Nuk ka diskutime.)

Kalojmë në votim.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord me vlerësimin. Shpreh edhe unë konsideratat e mia personale për shkak të njohjes dhe punës që kam bërë me këtë gjyqtare dhe ato çfarë u diskutuan në këtë raport nga relatorja i konstatoj edhe vetë si gjyqtar që kam punuar bashkërisht me të.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtares {...} për periudhën 2013-2016. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Gjithsej 391 pikë.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.03.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, relatore znj. Yllka Rupa.²

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 12:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)

² Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4-ta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

9. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

10. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

11. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

12. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

13. Valbona Bala, eksperte të EWMI/INL.

14. Arben Lila, eksperti projektit EU4Justice.

15. Edmond {...}j, Birn.

16. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, relatore *znj. Yllka Rupa*.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja tjetër, e cila edhe kjo ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional me qëllim gradimi për gjyqtaren {...}. Përsëri shkurtimisht *znj. Yllka Rupa* do të bëjë prezantimin.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Edhe gjyqtarja {...} vlerësohet për periudhën 2013-2016 dhe ky projektraport ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtares e cila ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar.

Gjyqtares i është komunikuar projektraporti dhe nuk ka paraqitur kundërshtime, prandaj do të relatoj lidhur me vlerësimin e gjithsecilit nga kriteret.

“Aftësitë profesionale të gjyqtares”, në lidhje me 1.A.a Aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve. Për këto arsye propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Në lidhje me 1.A.b. Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjeve, rezulton se gjyqtarja ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, ka identifikuar praktikën e Gjykatës së Lartë. Gjithashtu evidentohet edhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të së drejtës në të gjitha arsyetimet e vendimeve. Lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Në lidhje me Arsyetimin ligjor, rezulton se gjyqtarja {...} ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Kështu që lidhur me këtë tregues propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë (vlerësimi është shumë i lartë).

Lidhur me 1.B.b. Strukturën e qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se kjo gjyqtare në hartimin e vendimeve gjyqësore ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të mirë organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 10.

Për sa i takon 1.B.c. Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik, në shumicën e vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin penal/civil objekt shqyrtimi, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u

analizuar në raport me aspektet procedurale, si në rastet kur ai përbën shkak ankimi ashtu edhe në rastet kur analiza e fakteve dhe dispozitave me natyrë procedurale është thelbësore për zgjidhjen e çështjes. Lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Propozimi për nivelin e vlerësimit “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, propozohet të jetë niveli “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Lidhur me “Aftësitë organizative të gjyqtares”, 2.A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, dhe 2.B. Aftësia për të kryer procedura gjyqësore, në aspektin e 2.A.a. Respektimit të afateve ligjore. Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Nga vëzhgimi i këtyre çështjeve rezulton se për vetëm për dy prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi. Më konkretisht është një vendim i zgjedhur nga gjyqtarja me nr.103, datë 27.01.2015, është regjistruar në gjykatën Administrative të Apelit në datën 03.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 27.01.2015. Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 24 ditë. Ky gjykim konsiderohet i përfunduar jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, por në mungesë të dhënave mbi datën e vënies në lëvizje të çështjes nga ana gjyqtares për shqyrtimin e kësaj çështjeje si dhe të datës së caktimit të çështjes gjyqtares e cila në Gjykatën Administrative të Apelit ka qene e deleguar, ky vendim nuk mundet të merret si burim vlerësimi. Ndërsa për çështjen tjetër (çështje civile), rezulton se është regjistruar në gjykatë në datë 15.01.2013 dhe me shortin elektronik të datës 02.07.2013 i është caktuar gjyqtares {...}. Nga aktet e dosjes rezulton se ajo është vënë në lëvizje nga Kryetari i gjykatës së Apelit Tiranë duke planifikuar seancën e parë në datë 22.11.2013, dhe ka përfunduar në datë 22.11.2013. Çështja e mësipërme ka përfunduar brenda një seance të vetme dhe konsiderohet se është respektuar afati ligjor për shqyrtimin e saj.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar dy çështjeve të analizuara më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin e 15 pikëve.

Lidhur me 2.A.b. Plotësimin e standardeve minimale kohore, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuara kështu që propozohet niveli i vlerësimit për këtë tregues me 5 pikë.

Për sa i takon 2.A.c. Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha çështjet e kësaj kategorie, kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë.

Lidhur me 2.A.ç. Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore, referuar të dhënave të paraqitura në formularin e vetëdeklarimit rezulton se gjyqtarës i janë caktuar për gjykim 1337 çështje, nga të cilat ka përfunduar 858 çështje civile dhe penale si dhe 47 çështje administrative si gjyqtare e deleguar pranë Gjykatës Administrative të Apelit që në total përbejnë 905 çështje të përfunduara. Nga ky raport rezulton se për gjyqtaren llogaritet një rendiment prej 67.8%.

Në bazë të statistikave, të përcjella nga Gjykata e Apelit kemi të dhëna vetëm sa i takon totalit të çështjeve të përfunduara nga gjyqtarja që përputhet me atë të deklaruar prej saj. Pra rezultojnë 857 çështje në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe 47 çështje të gjykuara si gjyqtare e deleguar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Vlerësuar si raport të çështjeve të gjykuara me ato të caktuara, rendimenti për llogaritet në masën 67.8%, përqindje e cila sipas metodologjisë përkon me vlerësimin me 2 pikë.

Për sa i takon standardit sasior, referuar të dhënave për numrin e çështjeve të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, sipas të dhënave statistikore të administruara për efekte të organizimit të shortit gjatë procesit të rivlerësimit, ka rezultuar se gjyqtarja ka përfunduar rreth 700 çështje me palë kundërshtare, nga të cilat 653 (civile dhe penale themeli) si dhe 47 çështje si gjyqtare e deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit duke përmbushur standardin sasior në fuqi, me 116 %, por ajo çfarë duhet theksuar

është se përqindja e çështjeve me pale kundërshtare të përfunduara nga gjyqtarja përbën 77.3% të çështjeve në total të përfunduara prej saj. Bazuar në këtë parashikim, duke konsideruar (i) ngarkesën e përgjithshme në punë të gjyqtarës e cila rezulton të ketë përfunduar si relatore në total 905 çështje ose mesatarisht 301 çështje në vit; (ii) angazhimin e gjyqtarës në plotësimin e trupave gjykues në gjykatën e apelit; (iii) faktin që nxjerrja e çështjeve civile për gjykim në periudhën e vlerësimit, 2013-2016 ka qenë atribut i Kryetarit të Gjykatës dhe nuk ishte në vullnetin e gjyqtarës; (iv) angazhimin në gjykimin e 47 çështjeve si gjyqtare e deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit, vlerësoj se për këtë tregues, niveli i pikëzimit që përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarës duhet të rritet me 2 shkallë, duke u pikëzuar me 6 pikë.

Për të kaluar tek 2.A.d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar, që referuar burimeve të vlerësimit ka rezultuar “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”. Në këto kushte propozohet vlerësimi i gjyqtarës për këtë tregues me 15 pikë.

Në lidhje me “Kryerjen e procedurave gjyqësore”, 2.B.a Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore në dosje e analizuara është më i vogël se 3, si dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, vlerësoj se gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Në lidhje me 2.B.b Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, evidentohet se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në aspektin e korrektesisë, planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektesë hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 20.

Në lidhje me “Aftësitë e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore”, në aspektin e 2.C.a Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes po ashtu edhe në aspektin e 2.C.b Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes, propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 5 dhe 10, për arsye sepse dosjet paraqiten të rregullta në

aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Gjithashtu nuk konstatohen mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumentave që nuk i përkasin çështjeve konkrete.

Lidhur me këtë kriter “Aftësitë organizative të gjyqtarës” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100 (96 pikë).

Lidhur me “Etikën në punë”, në burimet e vlerësimit për këtë kriter nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës, kështu që të gjitha komponentët që pikëzojnë kriterin e “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, është propozuar nivel shumë i lartë vlerësimi, pikët maksimale. Propozimi për nivelin e vlerësimit për “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale” është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me “Aftësitë personale dhe angazhimin profesional”. Për sa i takon “Aftësi të komunikimit”, gjyqtarja paraqitet në nivele shumë të mira si në aspektin e komunikimit të qartë dhe transparent. Gjithashtu respekton konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Kështu që për të dy këto tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25 dhe 15.

Gjithashtu gjyqtarja ka aftësi shumë të mira bashkëpunuese si në aspektin e bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta ashtu edhe në aspektin e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo për ezistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarës me kolegët dhe administratën gjyqësore. Kështu që propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, përkatësisht pikët 15 dhe 10 pikë për gjithsecilin nga këto dy tregues.

Lidhur me 4.C “Gatishmërinë e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, 4.C.a. “Pjesëmarrja e saj në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale” rezulton se gjyqtarja të ketë 16 ditë trajnimi për periudhën e vlerësimit. Duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtarës në aktivitetet trajnuese sipas të dhënave që rezultojnë, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, propozoj që lidhur me këtë komponent gjyqtarja të pikëzohet në nivelin e 20 pikëve.

Për të kaluar tek 4.C.b. Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnimin e gjyqtarëve, referuar të dhënave nuk rezulton që gjyqtarja të ketë angazhime të tilla, kështu që vlerësohet me 3 pikë.

Po ashtu nuk rezulton që gjyqtarja të ketë dhënë kontribut gjatë kësaj periudhe vlerësimi në veprimtarinë ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Propozohet lidhur me këtë tregues pikëzimi me 3 pikë.

Gjithashtu gjyqtarja nuk rezulton të ketë publikime ligjore akademike, kështu që nuk vlerësohet lidhur me treguesin “Publikimet ligjore dhe akademike”

Lidhur me kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimin profesional”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 91.

Lidhur me propozimin për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi propozimi është si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarës, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative të gjyqtarës, pikët 96, niveli "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për vlerësimin e përgjithshëm, janë pikët 387, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të relatores.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarës {...} për periudhën 2013-2016. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", me 387 pikë.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.03.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, relatore znj. Yllka Rupa.³

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 12:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

17. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

18. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

19. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

20. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

21. Valbona Bala, eksperte të EWMI/INL.

22. Arben Lila, eksperti projektit EU4Justice.

23. Edmond Hoxhaj, Birn.

24. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, relatore *znj. Yllka Rupa*.

Naureda Llagami: Kalojmë tek vlerësimi i radhës që ka të bëjë me gjyqtaren {...}. Sërish është *znj. Yllka Rupa*. Shkurtimisht, pasi anëtarët janë vënë në dijeni me raportin.

Yllka Rupa: Edhe gjyqtarja {...} vlerësohet në drejtim të etikës dhe veprimtarisë profesionale me qëllim përcaktimin e nivelit të gradimit për periudhën 2013-2016. Duke qenë se gjyqtarja nuk ka paraqitur kundërshtime në formë konkluzionesh po relatoj lidhur me nivelin e pikëzimit dhe vlerësimin për secilin nga kriteret.

Lidhur me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, në aspektin e “Njohurive ligjore”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikë 25.

Lidhur me 1.A.b Aftësinë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes, referuar të dhënave rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira lidhur me këtë komponent dhe për këtë arsye propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Në lidhje me 1.B. Arsytimin ligjor, në tërësi rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë dhe koncizitetit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit të mendimit, mundësojnë një lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Kështu që lidhur me komponentin “Qartësia, koncizitetit dhe kuptueshmëria e vendimit”, propozohet nivel shumë i lartë i vlerësimit, pikët 15.

Për sa i takon 1.B.b. Strukturës së qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit gjyqësor. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 10.

Lidhur me 1.B.c. Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë për këtë tregues. Gjyqtarja analizon konceptet ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes mbi bazën e një zhvillimi dhe argumenti logjik. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion. Në secilin prej tyre mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit përpos edhe qëndrimeve të praktikës gjyqësore që janë të integruara në vendimet e analizuara. Lidhur me këtë tregues propozohet niveli i pikëzimit me 25 pikë.

Propozimi për “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, është niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Lidhur me “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, të cilat analizohet dhe pikëzohen në aspektin e aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë dhe për të kryer procedura

gjqësore, lidhur me 2.A.a. Respektimin e afateve ligjore, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Nga vëzhgimi i këtyre çështjeve, referuar kategorisë së tyre rezulton se vetëm për dy prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit. Duke iu referuar çështjeve për të cilën ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, rezulton se për 1 (një), nga 2 (dy) prej tyre, ose 50% të tyre vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor. Duke iu referuar vetëm dy çështjeve të analizuara më sipër por edhe ngarkesës së gjyqtarës {...} për periudhën e vlerësimit, vlerësoj që lidhur me këtë tregues, gjyqtarja të mos vlerësohet në nivelin e 3 pikëve siç parashikon metodologjia në një interpretim matematikor të çështjeve por të rritet në dy nivele duke pasur në konsideratë edhe analizën e disa aspekteve të cilat nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës dhe të cilat janë trajtuar dhe detajuar në projektraportin e vlerësimit. Kështu që propozohet lidhur me këtë tregues pikëzimi i gjyqtarës me 9 pikë.

Për sa i takon 2.A.b. Plotësimin të standardeve minimale kohore, standardi minimal kohor në fuqi është respektuar vetëm për 58.4 % të çështjeve të analizuara. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 41.6 % përkon me nivelin e vlerësimit 1 (një) pikë. Por vlerësuesi veç analizës me shifra duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Kështu që projektraport pasqyrohen analiza e komponentëve të tillë si ngarkesa e gjyqtarës, kompleksiteti i çështjeve dhe shkaqe të tjera që justifikojnë një pikëzim më të lartë të gjyqtarës lidhur me këtë tregues. Kështu që propozohet lidhur me treguesin “Respektimi i standardeve minimale kohore”, pikëzimi me 3 pikë.

Për sa i takon 2.A.c. Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, referuar burimeve të vlerësimit kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve, por duke marrë në konsideratë faktin se “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” tejkalohe vetëm për

një kategori dhe kjo është kategoria e çështjeve civile me palë kundërshtare, si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja, angazhimin dhe përfundimin në kohë të çështjeve, natyrës, ecurisë procedurale të tyre që ka kushtëzuar përfundimin e çështjeve tej standardit minimal, vlerësoj se ky tregues duhet të pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

Për sa i takon 2.A.ç. Rendimentit të përfundimit të çështjeve, referuar burimeve rezulton në masën 103 % rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit, kështu që referuar edhe metodologjisë së pikëzimit, përqindja pikëzohet me 10 pikë.

Lidhur me 2.A.d. Kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar, në tërësi koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Duke mbajtur në konsideratë se tejkalimi i afatit konstatohet vetëm për një kategori çështjesh familjare si dhe referuar ngarkesës në punë të gjyqtarës duke aplikuar koeficientin 20% të rritjes me një shkallë pikëzimi, për këtë kriter propozoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin e 15 pikëve.

Lidhur me 2.B. Aftësitë e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore, në total numri mesatar i seancave ka rezultuar 4.1 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve, por duke iu referuar burimeve të vlerësimit pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimi në tërësi të procesit është e lartë, ndaj gjyqtarja propozohet të vlerësohet në nivelin e 15 pikëve.

Lidhur me 2.B.b Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Propozohet lidhur me këtë tregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 20.

Në aspektin e 2.C Aftësive të gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore, për sa i takon 2.C.a Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes, nga analiza e burimeve të vlerësimit rezulton se dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë

të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi. Propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë.

Gjithashtu edhe në aspektin e 2.C.b Saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes, propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 10, sepse rezulton i plotë dhe i saktë dokumentacioni në çdo dosje të analizuar dhe të vëzhguar.

Kështu që në lidhje me “Aftësitë organizative të gjyqtares” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 92.

Lidhur me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, për sa i takon “Etikës në punë”, 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye propozohet nivel shumë i lartë pikëzimi, pikët 35.

Po ashtu edhe në lidhje me 3.B. Integritetin e gjyqtares, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 40.

Për sa i takon 3.C. Paanësisë së gjyqtares, 3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese, nuk rezulton pra nga aktet, burimet e vlerësimit, nuk rezulton përdorimi i një gjuhe diskriminuese nga ana e saj. Kështu që propozohet nivel shumë i lartë komunikimi, pikët 10.

Gjithashtu referuar të dhënave, rezulton se ka vetëm një kërkesë për përjashtim nga pala e cila është rrëzuar më pas dhe është shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues. Për këtë arsye për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” vlerësohet i pakonsiderueshëm dhe propozohet niveli i vlerësimit me 15 pikë për këtë tregues.

Kështu që, propozimi për nivelin e vlerësimit lidhur me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale” propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Lidhur me “Aftësitë personale dhe angazhimin profesional”. Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti profesional dhe angazhimi personal i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit, dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale. Për sa i takon “Aftësisë së komunikimit”, gjyqtarja rezulton të ketë komunikim të qartë dhe

transparent kështu që propozohet lidhur me këtë tregues vlerësimi shumë i lartë, pikët 25.

Gjithashtu respekton konfidencialitetin dhe mbron të dhënat personale, privatësinë e palëve ndërgjyqëse dhe subjekteve të tjera të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 15.

Lidhur me aftësitë për të bashkëpunuar gjyqtarja ka aftësi shumë të mira komunikimi qoftë me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta (4.B.a), po ashtu edhe në aspektin e 4.B.b Komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 15 dhe 10.

Gjithashtu 4.C “Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, provohet në aspektin e 4.C.a. Pjesëmarrjes së gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, ku rezultojnë 15 ditë trajnimi dhe referuar legjislacionit të kohës, këto ditë përkojnë me një vlerësim maksimal të gjyqtares lidhur me këtë tregues. Propozoj vlerësimin me 20 pikë. 1:29

Për sa i takon 4.C.b. Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnimin e gjyqtarëve, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë angazhime të tilla, por edhe të ketë angazhime në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, kështu që vlerësohet me 3 pikë lidhur me këtë tregues.

Për sa i takon angazhimit të gjyqtares në 4.C.c. Veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata, nuk ka të dhëna lidhur me kontributin e saj për këtë tregues, kështu që propozohet niveli i pikëzimit 3 pikë.

Gjithashtu për sa i takon “Publikimeve ligjore dhe akademike”, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë të tilla, kështu që nuk vlerësohet lidhur me këtë tregues.

Në mënyrë të përmbledhur niveli i pikëzimit dhe i vlerësimit lidhur me kriterin “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional” për gjyqtaren, propozohet të jetë niveli “Shkëlqyeshëm”, pikët 91.

Lidhur me propozimin për nivelin e përgjithshëm të pikëzimit të gjyqtarës propozohet të jetë si më poshtë:

Aftësitë profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative, pikët 92, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për vlerësimin e përgjithshëm është niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 383.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, atëherë ftoj kolegët që të kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të relatores.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi, miratimin e raportit të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi të gjyqtarës {...}, për periudhën 2013-2016. Niveli i përgjithshëm i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Numri i pikëve 383.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.03.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga KVEVP:⁴

4.1 “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e Këshilltarit Ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

4.2 “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e Nëpunësit Përgjegjës për Vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

4.3 “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e Nëpunësit Përgjegjës për Vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 12:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e fundit sipas rendit të ditës.

- | | |
|---------------------------|------------------|
| 3. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 4. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 7. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 10. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

25. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
26. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
27. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
28. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
29. *Valbona Bala, eksperte të EWMI/INL.*
30. *Arben Lila, eksperti projektit EU4Justice.*
31. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
32. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtim i projektvendimeve të përgatitura nga KVEVP:
 - 4.1 “Për komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e Këshilltarit Ligjor, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.
 - 4.2 “Për komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e Nëpunësit Përgjegjës për

Vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

4.3 “Për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin e Nëpunësit Përgjegjës për Vlerësimin, në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë sipas rendit të ditës tek çështja e radhës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Vlerësimit lidhur me komandimin e tre magistratëve pranë KLGJ-së, konkretisht një në pozicionin e këshilltares ligjore në njësinë mbështetëse të komisioneve të përhershme dhe dy në pozicionin e nëpunëses përgjegjëse për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Projekt-aktet do relatohen nga zonja Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur relacionin për tre projektvendimet për komandimin e gjyqtarës {...}, gjyqtarës {...} dhe gjyqtarës {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja “b” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për 4 (katër) pozicione “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” dhe 1 (një) pozicion në pozicionin e “Këshilltares”.

Brenda afatit të kandidimit kanë shfaqur interes 4 gjyqtare.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen e datës 13.03.2023 (në fakt është 2024) ka miratuar opinionin në lidhje me plotësimin e kushteve për komandim dhe cenimin ose jo të funksionalitetit.

Më pas Këshilli ka vendosur vijimin e procedurës së komandimit në Komisionin e Vlerësimit Etik dhe Profesional me vlerësimin e kriterëve të tjera të komandimit për gjyqtarët: znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} duke përjashtuar gjyqtarën {...}.

Në këtë kuadër, referuar vendimit nr.38/2024, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale filloi fazën e dytë të procedurës së komandimit, me qëllim kryerjen e vlerësimit vetëm të kandidatëve, për të cilët është lejuar nga Këshilli, vijimi i procedurave të komandimit, konkretisht të:

(i) Gjyqtarës {...}, e cila ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në pozicionin e "Këshilltares"; {...} dhe {...}, të cilat kanë shfaqur interesin për t'u komanduar në cilësinë e nëpunëses së vlerësimit.

(iii) Gjyqtarës, e cila ka shfaqur vullnetin për t'u komanduar në një nga pozicionet e shpallura për "Nëpunës përgjegjës për vlerësimin".

Në fazën e dytë, lidhur me vlerësimin e kritereve të komandimit, sipas vendimit nr. 38/2024, bëhet nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional.

Gjatë procedurës së vlerësimit, Komisioni pati parasysh edhe kriteret preferenciale të parashikuara në vendimin nr. 38/2024, konkretisht: ekspertizën e veçantë; ka njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian; është autore e artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të BE-së; ka aftësi shumë të mira organizative, personale, si dhe etikë të lartë.

Për pozicionin e këshilltares ka kandiduar, siç e thamë, znj. {...}. Kjo e fundit ka filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2017, duke i përfunduar ato në vitin 2020 duke u vlerësuar në nivelin e vlerësimit "Shumë mirë", dhe është renditur e para ndër magjistratët e diplomuar. Me vendimin nr.473/2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar gjyqtare dhe më pas me vendimin nr.503 është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Me vendimin nr. 130, datë 28.03.2023 "Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës", është transferuar në këtë gjykatë ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrrojë detyrën. Ajo ka përvojë profesionale më të gjatë se 3 vjet.

Nga pesë dokumentet ligjore të paraqitur prej saj, konkludohet se ajo ka aftësi shumë të mira profesionale. Në çdo dokument ligjor, gjyqtarja i referohet provave të lejuara për shqyrtim [...], etj.

Lidhur me aftësitë organizative referuar të dhënave statistikore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të administruar nga Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ka rezultuar se gjatë vitit 2023 ka përfunduar së gjykuari 578 çështje, nga 801 çështje të caktuara për shqyrtim, duke mbartur për vitin pasardhës rreth 500 çështje, indikatorë të cilat tregojnë se gjyqtarja ka aftësi të mira organizative.

Lidhur me kriterin preferencial të kandidimit – ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve dhe rregulloreve, ka rezultuar se gjatë vitit 2014-2017 ajo ka punuar në Kuvendin e Shqipërisë, ku gjatë kësaj periudhe është angazhuar si eksperte në sekretariatit teknik, të Komisionit të Posaçëm i Reformës në Drejtësi.

Lidhur me kriterin preferencial të njohurisë së gjuhës, rezulton se kjo e fundit ka njohuri të posaçme në gjuhën angleze, si dhe njohuri të mira të gjuhës italiane (të referuara nga vetë gjyqtarja).

Gjyqtarja përgjatë viteve 2020-2023 rezulton të jetë angazhuar në programin e trajnimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses.

Lidhur me kriterin preferencial të kandidimit – njohuri mbi legjislacionin BE-së, rezulton se referuar dokumenteve ka referuar këto akte në vendimet e saj por nuk rezulton që të ketë botime apo artikuj shkencor.

Nga ana e Komisionit është vlerësuar se gjyqtarja përmbush kushtet për t'u caktuar si këshilltare ligjore dhe për këtë rast nuk është e nevojshme renditja për sa kohë që ka qenë vetëm një kandidate.

Për pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” lidhur me gjyqtaren {...}. Kjo e fundit ka filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015, duke i përfunduar ato në vitin 2018, duke u vlerësuar “Shumë mirë”, duke u renditur e gjashta ndër magjistratët e diplomuar për këtë vit. Me vendimin nr.129/2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është emëruar gjyqtare. Me vendimin nr.150/2019 është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, dhe aktualisht vazhdon punën. Pra rezulton se ajo ka një përvojë profesionale prej 4 vjetësh, periudhë gjatë të cilës gjyqtarja ka shqyrtuar çështje të natyrës civile, penale dhe familjare. Gjithashtu, prej datës 13.01.2023 e në vijim ka ushtruar funksionin e zëvendëskryetares së gjykatës.

Gjatë periudhës së punës, gjyqtarja është vlerësuar nga Këshilli në drejtim të etikës dhe aftësive profesionale, për periudhën e vlerësimit 2020-2022, duke u vlerësuar për katër kriteret e vlerësimit, niveli i përgjithshëm i vlerësimit për të gjitha këto kritere është vlerësuar “Shkëlqyeshëm”.

Lidhur me kriterin preferencial – njohuri të mira të paktën të një gjuhe, rezulton se ajo ka njohuri të mira të gjuhës angleze, si dhe njohuri të gjuhës italiane.

Lidhur me kriterin – njohuri mbi legjislacionin e vendeve të BE-së, nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk rezultojnë të dhëna mbi njohuri të legjislacionit të vendeve të BE-së apo akte ndërkombëtare në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor. Lidhur me kriterin preferencial nuk rezulton të ketë artikuj apo botime shkencore.

Sa i përket gjyqtarës {...}, ajo ka filluar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2017 dhe i ka përfunduar në vitin 2020. Për sa i përket aftësive profesionale gjatë studimeve është vlerësuar “Shumë mirë”, duke u renditur e nënta ndër magistratët e vitit akademik. Me vendimin nr.476/2020 është emëruar gjyqtare dhe më pas me vendimin nr.511/2020 është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ku aktualisht vazhdon të jetë në pozicionin e gjyqtarës dhe ka një përvojë profesionale më shumë se 3 vjet.

Ka paraqitur disa dokumente ligjorë për t’u vlerësuar. Nga këto kanë rezultuar aftësi të mira për paraqitjen e rrethanave të faktit, aftësi të mira ligjore. Në lidhje me aftësitë organizative referuar të dhënave statistikore rezulton se për vitin 2023, ka përfunduar 560 çështje, nga 975 çështje që ka patur për shqyrtim, duke mbaruar për vitin pasardhës 451 çështje, indikator ky që tregon se gjyqtarja ka aftësi të mira organizative.

Lidhur me kriterin preferencial – njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian – rezulton se ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, shumë të mira të gjuhës turke, si dhe njohuri shumë të mira të gjuhës italiane (këto të referuara nga gjyqtarja).

Lidhur me kriterin preferencial – njohuri mbi legjislacionin të vendeve të BE-së - nga shqyrtimi i dokumentacionit, nuk rezultojnë të dhëna mbi njohuri të legjislacionit të vendeve të BE-së.

Gjithashtu lidhur me kriterin preferencial të kandidimit, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë autore apo bashkautore e ndonjë artikulli shkencor.

Referuar të dhënave të mësipërme, Komisioni ka vlerësuar se të dyja gjyqtaret shfaqin aftësi të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale dhe zotërojnë shumë mirë gjuhën angleze. Pavarësisht se nuk kanë eksperiencë profesionale në draftimin e akteve rregullatore, është propozuar që këto gjyqtare të komandohen.

Lidhur me kushtin e konfliktit të interesit, nga ana e komisionit, pas miratimit të vendimit të Këshillit për opinionin mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar në KLGJ i është njoftuar pika 33 e këtij opinionit dhe gjyqtaret kanë hequr dorë nga kandidimi për procedurat e lëvizjeve paralele.

Lidhur me datën efektive të komandimit, për sa i përket gjyqtarës {...}, ka dy çështje, të cilat sipas informacionit të marrë në datë 18.03.2024, ka dy çështje të karakterit urgjent me objekt verifikim i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes; 42 (dyzet e dy) çështje të cilat ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, prej të cilave 18 (tetëmbëdhjetë) çështje civile dhe 24 (njëzet e katër) çështje penale; 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) çështje të kaluara për shqyrtim në seancë gjyqësore, prej të cilave 82 (tetëdhjetë e dy) çështje civile dhe 80 (tetëdhjetë) çështje penale.

Gjithashtu nga informacioni, rezulton se janë 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) çështje në seancë përgatitore, 38 (tridhjetë e tetë) çështje të pezulluara dhe 29 (njëzet e nëntë) çështje pa caktuar datë seance.

Gjithashtu gjyqtarja {...} ka për shqyrtim 2 (dy) çështje të karakterit urgjent me objekt verifikim i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes; 6 (gjashtë) çështje të cilat ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare; 9 (nëntë) çështje të kaluara për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Ndërsa gjyqtarja {...} rezulton se ka 0 (zero) çështje të karakterit urgjent; 1 (një) çështje e cila ndodhet në fazën e konkluzioneve përfundimtare; 62 (gjashtëdhjetë e dy) çështje të kaluara për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Sipas një informacioni të fundit të marrë, në fakt edhe për gjyqtaren {...}, kjo e fundit ka relatuar se ka vetëm 3 çështje në fazën e konkluzioneve që i ka caktuar ditën

e nesërme, kështu që është dakord, pasur parasysh edhe nevojën që ne kemi në Këshill që maksimumi t'i lëmë një javë kohë, për shembull deri të mërkurën ose të enjten javën tjetër (si ta vlerësoni juve – është një propozim i imi).\

Ndërsa për sa i përket gjyqtarës {...} ka rezultuar se ka një numër të konsiderueshëm të çështjeve në seancë gjyqësore. Por gjithsesi do e diskutojmë për sa i përket datë në kushtet kur nga ana e Këshillit mendohet që do merren masa të tjera për transferimin e një gjyqtareje e cila është e vetme në pozicionin e lëvizjes paralele të shpallur më parë nga Këshilli.

Për sa i përket gjyqtarës {...}, kjo e fundit nëpërmjet një e-maili të datës 20.03.2024 ka relatuar se ka rreth 57 çështje në konkluzione përfundimtare në çështjet civile që janë në gjykim dhe nuk ka kërkesa për objekt shtesë, janë 41 çështje. Për sa i përket përfundimit, ka parashikuar “...deri në fund të muajit prill duke organizuar punën që të riplanifikojë çështjet e planifikuara që më parë në muajin maj, që të përfundoj unë”. Çështjet në gjykim penal janë shumë me dëshmitarë dhe sapo është hapur shqyrtimi gjyqtar, çështjet janë me shumë palë ndërgjyqëse. Ndër të tjera ka relatuar se ka edhe 28, gjatë kësaj kohe që është nga momenti i shpalljes së vendimit, domethënë nga data 18 deri në datën 20 ka shpallur rreth 18 vendime.

Për sa i përket datës së komandimit, ne mendojmë pasur parasysh se gjyqtarja ka relatuar se mund të përfundojë çështjet deri në fund të prillit, mund të lëmë një datë nga fillimi i majit. Të propozojmë 15 majin?

Naureda Llagami: Atëherë edhe një herë, për të qenë më konkret. Lidhur me komandimin e gjyqtarës {...}, çfarë sugjeroni të jetë?

Atëherë 08.04.

Lidhur me propozimin për fillimin e {...}. Më datë 3.

Dhe për zonjën {...} data 15 maj.

A jemi dakord? Kalojmë në votim.

(Anëtarët diskutojnë edhe një herë lidhur me fillimin e detyrës së komandimit.)

Irena Plaku: Atëherë, pasur parasysh ngarkesën e gjyqtares {...} e cila ka një ngarkesë tepër të vogël, unë propozoj që të jetë javën tjetër, konkretisht data 3 prill. Pasur parasysh edhe nevojën që kemi ne këtu në Këshill për nëpunëset përgjegjëse.

Për sa i përket gjyqtares {...}, pasur parasysh ngarkesën e kësaj gjyqtareje, e cila është tepër e lartë, numrin e gjyqtarëve që ndodhen efektivisht në punë në Gjykatën e Beratit e cila do të marrin edhe çështjet e tjera me short, dhe e-mailin e vetë gjyqtares e cila ka relatuar në fakt që deri në fund të muajit prill përfundon disa çështje; gjithashtu vlerësohet që deri në këtë kohë ndaj Këshillit merren masa edhe për caktimin e ndonjë gjyqtari, prandaj propozohet që data të jetë rreth 15 majit.

Ndërsa për sa i përket gjyqtares {...}, megjithëse kjo e fundit ka një ngarkesë tepër të lartë të çështjeve, vlerësojmë që të ketë një datë më të afërt, me qëllim për t'i lënë kohë gjyqtares për të përfunduar çështjet që ka në kunkluzion përfundimtar dhe për të dorëzuar dosjet, pasur parasysh që nga ana e Këshillit, menjëherë pas kësaj procedure, do fillojnë procedurat për transferimin e gjyqtares e cila është e vetme në një pozicion në procedurat e lëvizjes paralele, siç kemi proceduar dhe më parë në rastet e ngjashme, kur gjyqtarët që kanë qenë në pozicion të vetme, janë transferuar përkohësisht deri në përfundimin e vlerësimit dhe kjo nuk cenon as barazinë e kandidimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, duke vlerësuar atë që tha relatorja, jemi dakord me propozimet e datave për secilën?

Fillojmë me projekt-aktin e parë që ka të bëjë me komandimin e gjyqtares {...} në pozicionin e këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Propozohet që periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 08.04.2024. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti.

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i dytë për komandimin e gjyqtarës {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 03.04.2024. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti.

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i tretë që është komandimi i gjyqtarës {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datën 15.05.2024.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.03.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 242, nr. 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 12:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e para sipas rendit të ditës.

8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

33. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
34. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
35. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
36. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
37. *Valbona Bala, eksperte të EWMI/INL.*
38. *Arben Lila, eksperti projektit EU4Justice.*
39. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
40. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 242, nr. 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ridvan Hado).

Naureda Llagami: Kalojmë tek dy aktet e fundit për të cilat z. Markelian ka papajtueshmëri për të qëndruar në shqyrtimin e këtyre dy akteve. Mund të vazhdojë për të lejuar Këshillin në marrjen në shqyrtim të projekt-aktit të parë, i cili ka të bëjë me

përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 242, nr. 246, nr. 247, datë 24.05.2023, për kandidatin z. {...}. Më konkretisht fjalën ia jap z. Kurushi. Ndjesë, e paska z. Ridvan Hado.

(Largohet nga salla e mbledhjes z. Markelian Koça.)

Ridvan Hado: Faleminderit!

Me vendimet nr. 242, nr. 246, nr. 247, datë 24.05.2023 të KLGJ-së është vendosur hapja e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e së drejtës civile.

Brenda afatit kohor ka kandiduar dhe zoti {...}.

Me vendimin nr. 57 Këshilli ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile. Nga shorti jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje për kandidatin {...}.

Mbasi ka filluar procedura e verifikimit, ndërkohë në datën 12.03.2024, kandidati {...} ka parashtruar një kërkesë për tërheqje nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 242, nr. 246, nr. 247, datë 24.05.2023.

Në datë 12.03.2023 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe po ashtu, vlerëson të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur për t'u tërhequr nga kandidimi, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 242 nr. 246 dhe nr. 247, datë 24.05.2023, në referim të pikës 17, Seksioni B dhe 3, Seksioni C, të Kreut VI të Vendimit nr. 75/2019, vendosi dërgimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.03.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 13.03.2024).⁶

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 12:15.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta sipas rendit të ditës.

- 6. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
- 7. *Ridvan Hado* (anëtar)
- 8. *Alban Toro* (anëtar)
- 9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi.*

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje z. *Markelian Koça.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 41. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 42. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 43. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 44. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 45. *Valbona Bala, eksperte të EWMI/INL.*
- 46. *Arben Lila, eksperti projektit EU4Justice.*
- 47. *Edmond Hoxhaj, Birn.*
- 48. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi). (shtyrë nga mbledhja plenare e datës 13.03.2024).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i dytë që ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja {...} të tre kritereve të kandidimit për pozicionet fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për më shumë detaje fjalën e ka zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë, shkurtimisht po paraqes relacionin që është bashkëngjitur vendimit, në lidhje me gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të kandidatës znj. {...}.

KLJGJ me vendimet nr. 239, nr. 240 dhe nr. 241 datë 24.05.2023 ka vendosur hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile. Në këto tre pozicione të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paraqitur interes (kërkesë pranë KLJGJ-së) edhe kandidatja zonja {...}.

Referuar nenit 47 të ligjit “Për statusin”, KZHK filloi punën për verifikimin e tre kritereve ligjore formale që lidhen me rastin e verifikimit të kandidatëve.

Më konkretisht, rezultatet e verifikimit paraprak për tre kriteret e kandidimit janë:

Për zonjën {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”. Duke marrë të gjithë dokumentacionin përmbledhës për të verifikuar kriterin e përvojës profesionale minimale, sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 01.07.2001 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2005.

Me dekretin nr. {...}, datë 17.09.2004 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare dhe caktohet për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me dekretin nr. {...}, datë 03.10.2005 të Presidentit të Republikës caktohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë Lushnjë.

Me dekretin nr. {...}, datë 24.07.2014 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, datë 09.01.2019 zgjidhet Zëvendëskryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 16.03.2022 dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtare pranë kësaj gjykate.

Me vendim nr. 271, datë 25.05.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të riorganizuar”, nga data 01.07.2023 transferohet në pozicion të përhershëm si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku dhe aktualisht ushtron funksionin.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magistratit është 19 vite.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr. 240 dhe nr. 241, datë 24.05.2023, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në fushën civile pranë gjykatave të sipërpërmendura për një periudhë të paktën 5 vjet.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të mbledhur nga KLGJ, pra nga Komisioni, ka rezultuar se “... Znj. {...} ka ushtruar funksionet e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë Vlorë, prej periudhës tetor 2004 - tetor 2005. Gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesë e seksioneve gjyqësore si më poshtë:

1. Për periudhën tetor 2005, ka kryer stazhin profesional në Kolegjin Civil (Urdhër datë 01.01.2005).

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, (referuar informacionit për Gjykatën e

Shkallës së Parë Lushnjë), sipas urdhrave për ndarjen e gjyqtarëve në dhomë/seksione dhe trupa gjykues për vitet 2005 - 2014, ku kjo gjyqtare ka ushtruar funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë Lushnje, ka rezultuar se:

Për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve pranë kësaj gjykate nuk ka pasur ndarje në dhoma penale apo civile. Çështjet penale janë shpërndarë me short ndërmjet gjithë gjyqtarëve, ndërsa për çështjet civile ka pasur ndarje në seksione. Konkretisht nga urdhrat e kryetarëve të gjykatës së rrethit gjyqësor Lushnjë, të përcjella për periudhën 2006 - 2014 ka rezultuar se: kandidatja në vitin 2006 ka qenë pjesë e seksionit tregtar dhe civil të përgjithshëm; në vitin 2007 pjesë e seksionit administrativ; në vitin 2008 -2010 pjesë e seksionit civil të përgjithshëm; në vitin 2011-2012 pjesë e seksionit civil dhe tregtar; Sipas urdhrat nr. {...} prot, datë 04.01.2013 të Kryetarit të Gjykatës së rrethit gjyqësor Lushnjë, -për vitin 2013-2014 gjyqtarët e kësaj gjykate do të gjykojnë të gjitha llojet e çështjeve, pa ndarje në Dhomë Civile (çështje civile, tregtare, administrative familjare) dhe Dhomë Penale.

Nga të dhënat e përmendura më lart nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e përmendura më lart, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Nga verifikimet e bëra nga Komisioni sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Njëkohësisht nga dokumentacioni i administruar gjatë këtij verifikimi nuk vërtetohet që kandidatja të ketë pasur masë disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit të saj si gjyqtare.

Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”, kriter i cili është parashikuar në nenin 8, pika 3, të ligjit 96/2016 “Për statusin” është marrë deklarata e saj dhe nga verifikimet e bëra nga Komisioni, nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, rezulton se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të

ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes së saj në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Duke i konsideruar të plota të gjitha verifikimet për tre kriteret ligjore formale të përmendura më lart, ne si Komision i propozojmë Këshillit në mbledhjen e sotme që të konsiderojë të përfunduar verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr. 240 dhe nr. 241, datë 24.05.2023, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Më tej propozojmë që të vijojë procedura e verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr. 240 dhe nr. 241, datë 24.05.2023.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë akti miratohet sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Me kaq po e mbylлим mbledhjen për sot. Faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor